



НАРОДНА БАНКА НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА

Në mbështetje të nenit 47, paragrafi 1, pika 6 të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15 dhe 6/16) dhe nenit 23, paragrafi 2 të Ligjit të Veprimtarisë me Valuta ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 34/01, 49/01, 103/01, 51/03, 81/08, 24/11, 135/11, 188/13, 97/15, 153/15 dhe 23/16), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi:

V E N D I M

për mënyrën dhe kushtet sipas të cilave rezidentët që nuk janë banka të autorizuar, mund të çelin dhe të kenë llogari jashtë vendit (Tekst i konsoliduar jozyrtar¹)

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim përcakton mënyrën dhe kushtet sipas të cilave rezidentët që nuk janë banka të autorizuar, mund të çelin dhe të kenë llogari jashtë vendit.

Llogaritë e paragrafit 1 të kësaj pike çelen:

- në bankat e huaja, si llogari transaksioni;
 - në organizatat e huaja jobankare, si llogari evidence për shlyerjen e kërkesave dhe detyrimeve të ndërsjella me jorezidentët (në tekstin e mëtejme: llogaritë e evidencës);
 - në institucione të huaja të pagesave ose institucione të parave elektronike;
- dhe
- në pjesëmarrësin e autorizuar në bursën e huaj ose në tregun e organizuar të letrave me vlerë.

Banka e huaj është person juridik i regjistruar dhe me seli jashtë Republikës së Maqedonisë, i cili ka autorizimin nga organi kompetent i vendit për të kryer veprimtari bankare.

Pjesëmarrës i autorizuar i bursës së huaj ose i tregut të organizuar të letrave me vlerë është personi juridik që ka marrë lejen, pëlqimin ose licencën nga autoriteti kompetent jashtë vendit, për kryerjen e shërbimeve me letra me vlerë ose është regjistruar në regjistrin publik përkatës të pjesëmarrësve të autorizuar në tregjet financiare.

¹ Ky tekst i konsoliduar jozyrtar i Vendimit për mënyrën dhe kushtet sipas të cilave rezidentët që nuk janë banka të autorizuar, mund të çelin dhe të kenë llogari jashtë vendit është i përbërë nga Vendimi për mënyrën dhe kushtet sipas të cilave rezidentët që nuk janë banka të autorizuar, mund të çelin dhe të kenë llogari jashtë vendit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 42/16), Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për mënyrën dhe kushtet sipas të cilave rezidentët që nuk janë banka të autorizuar, mund të çelin dhe të kenë llogari jashtë vendit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 50/19), Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për mënyrën dhe kushtet sipas të cilave rezidentët që nuk janë banka të autorizuar, mund të çelin dhe të kenë llogari jashtë vendit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 181/19), Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për mënyrën dhe kushtet sipas të cilave rezidentët që nuk janë banka të autorizuar, mund të çelin dhe të kenë llogari jashtë vendit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 167/20), Vendimit për ndryshimin e Vendimit për mënyrën dhe kushtet sipas të cilave rezidentët që nuk janë banka të autorizuar, mund të çelin dhe të kenë llogari jashtë vendit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 308/20), Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për mënyrën dhe kushtet sipas të cilave rezidentët që nuk janë banka të autorizuar, mund të çelin dhe të kenë llogari jashtë vendit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 88/21), Vendimit për ndryshimin e Vendimit për mënyrën dhe kushtet sipas të cilave rezidentët që nuk janë banka të autorizuar, mund të çelin dhe të kenë llogari jashtë vendit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 177/21), Vendimit për plotësimin e Vendimit për mënyrën dhe kushtet sipas të cilave rezidentët që nuk janë banka të autorizuar, mund të çelin dhe të kenë llogari jashtë vendit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 247/21) dhe Vendimit për plotësimin e Vendimit për mënyrën dhe kushtet sipas të cilave rezidentët që nuk janë banka të autorizuar, mund të çelin dhe të kenë llogari jashtë vendit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 89/22).

Institucion i huaj i pagesave ose institucion i parave elektronike është personi juridik që ka marrë lejen, pëlqimin ose licencën nga autoriteti kompetent jashtë vendit, për të kryer shërbime të pagesave ose për të emetuar para elektronike ose është i regjistruar në regjistrin publik përkatës.

II. MËNYRA DHE KUSHTET SIPAS SË CILAVE REZIDENTËT QË NUK JANË BANKA TË AUTORIZUARA, MUND TË ÇELIN DHE TË KENI LLOGARI NË INSTITUCIONE TË HUAJA TË PAGESAVE OSE INSTITUCIONE TË PARAVE ELEKTRONIKE

2. Rezidentët që mund të çelin lirshëm dhe të kenë llogari në bankat e huaja janë:

2.1. Përfaqësitë diplomatike, konsullore dhe të tjera të Republikës së Maqedonisë jashtë vendit të cilat financohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejshëm: përfaqësi diplomatike).

Llogari në bankën e huaj mund të çelet mbi këtë bazë vetëm në vendin ku është hapur misioni diplomatik dhe mund të shfrytëzohet për transferimin e mjeteve në dhe nga jashtë vendit.

2.2. Personat fizik me vendbanim të përhershëm në Republikën e Maqedonisë, të cilët përkohësisht qëndrojnë jashtë vendit më shumë se 3 (tre) muaj, gjatë qëndrimit të tyre jashtë vendit.

Qëndrimi i përkohshëm jashtë vendit dëshmohet me dokument të vlefshëm për qëndrimin e rregulluar për më shumë se 3 (tre) muaj.

Dokumenti i lëshuar nga organi kompetent i vendit që rregullon qëndrimin në atë vend konsiderohet si dokument i vlefshëm për qëndrimin jashtë vendit.

Llogaria në bankën e huaj mund të çelet mbi këtë bazë vetëm në vendin nga i cili është lëshuar dokumenti i vlefshëm i qëndrimit dhe mund të shfrytëzohet vetëm për transferimin e mjeteve nga jashtë vendit.

2.3. Personat fizikë me vendbanim të përhershëm në Republikën e Maqedonisë, të cilët qëndrojnë 6 (gjashtë) muaj ose më shumë përkohësisht jashtë vendit gjatë qëndrimit të tyre jashtë vendit.

Qëndrimi i përkohshëm jashtë vendit dëshmohet me dokument të vlefshëm për qëndrimin 6 (gjashtë) muaj ose më shumë.

Dokumenti i lëshuar nga organi kompetent i vendit që rregullon qëndrimin në atë vend konsiderohet si dokument i vlefshëm për qëndrimin jashtë vendit.

Llogaria në bankën e huaj mund të çelet mbi këtë bazë vetëm në vendin nga i cili është lëshuar dokumenti i vlefshëm i qëndrimit dhe mund të shfrytëzohet vetëm për transferimin e mjeteve nga jashtë vendit.

2.4. Personat fizikë me vendbanim të përhershëm në Republikën e Maqedonisë, të cilët qëndrojnë jashtë vendit përkohësisht, gjatë qëndrimit të tyre jashtë vendit dhe kanë dokument të vlefshëm pune.

Dokument pune i vlefshëm nënkupton kontratën e punës të lidhur me punëdhënësin e huaj ose dokumentin tjetër të punësimit të lëshuar nga organi kompetent i shtetit të huaj, duke përfshirë vizën e punës që gjendet në dokumentin e udhëtimit, në të cilën përcaktohet periudha të cilës i referohen.

Llogaria në bankën e huaj mund të çelet mbi këtë bazë vetëm në vendin ku ndodhet selia e punëdhënësit të huaj dhe në vendin ku ndodhen pjesët organizative të

tij ose ku ndodhet autoriteti kompetent që ka lëshuar dokumentin e punës dhe mund të shfrytëzohet vetëm për transferimin e mjeteve nga jashtë vendit.

2.5. Personat fizikë me vendbanim të përhershëm në Republikën e Maqedonisë, të cilët qëndrojnë jashtë vendit përkohësisht si punonjës të misionit diplomatik jashtë vendit dhe anëtarët e familjeve të tyre të afërta, gjatë qëndrimit të tyre jashtë vendit dhe kanë dokument të vlefshëm për punë në përfaqësinë diplomatike jashtë vendit.

Dokument i vlefshëm për punë në mision diplomatik nënkupton dokumentin diplomatik të udhëtimit, dokument të lëshuar nga autoriteti kompetent i vendit që rregullon qëndrimin në atë vend, ose deklaratë me shkrim nga ambasadori, konsulli ose personi tjetër që drejton misionin, duke deklaruar se personi fizik është i punësuar në misionin diplomatik, përkatësisht është anëtar i familjes së ngushtë të personit të punësuar në përfaqësinë diplomatike.

Llogaria në bankën e huaj mund të çelet mbi këtë bazë vetëm në vendin ku ndodhet selia e misionit diplomatik dhe mund të shfrytëzohet për transferimin e mjeteve nga jashtë vendit.

2.6. Personat e huaj fizikë me qëndrim të përkohshëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Qëndrimi i përkohshëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut dëshmohet në bazë të vizës së vlefshme të qëndrimit ose vizës së vlefshme të punës prej të paktën 6 (gjashtë) muaj.

Llogaria në bankën e huaj mbi këtë bazë mund të shfrytëzohet për transferimin e mjeteve në dhe nga jashtë vendit.

2.7. Personat fizikë me vendbanim të përhershëm në Republikën e Maqedonisë të cilët jashtë vendit kanë fituar të drejtën për: pension personal, pension nga bashkëshorti i ndjerë, ndihmë sociale, shtesa për fëmijë, tarifa shkollare për fëmijën për shkak të prindit të ndjerë dhe shpërblim/dëmtim nga sigurimi i jetës. E drejta e fituar dëshmohet me dokumentacion përkatës të lëshuar nga organi kompetent jashtë vendit, si dhe për pagesën e shpërblimit/dëmit nga sigurimi i jetës dhe dëshmi që kontrata për sigurimin e jetës nuk është lidhur në kundërshtim me rregulloret në Republikën e Maqedonisë (dëshmi që personi fizik në momentin e lidhjes së kontratës, kishte statusin e jorezidentit ose ishte i punësuar nga një punëdhënës i huaj).

Llogaria në bankën e huaj, e çelur mbi këtë bazë, mund të çelet në vendin ku janë fituar të drejtat dhe mund të shfrytëzohet vetëm për transferimin e mjeteve nga jashtë, në bazë të këtyre të drejtave të fituara.

2.8. Personat fizikë me vendbanim të përhershëm në Republikën e Maqedonisë dhe njëkohësisht kanë dokument të vlefshëm udhëtimi të huaj, me të dhëna për adresën e vendbanimit jashtë vendit.

Llogaria në bankën e huaj mund të çelet mbi këtë bazë vetëm në vendin ku është lëshuar dokumenti i vlefshëm i udhëtimit dhe mund të shfrytëzohet për transferimin e mjeteve në dhe nga jashtë vendit.

2.9. Rezidentët që shitën pasurinë e paluajtshme jashtë vendit për shlyerjen e kërkesave nga shitja e pasurisë të paluajtshme.

Fitimi i pasurisë së paluajtshme jashtë vendit vërtetohet me dëshmi të kryerjes së regjistrimit në regjistrin e investimeve në pasuri të paluajtshme në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Shitja e pasurisë së paluajtshme dëshmohet me kontratën e shitblerjes.

Llogaria në bankën e huaj mund të çelet mbi këtë bazë vetëm në vendin ku është fituar pasuria e paluajtshme që është lëndë e kontratës së shitjes dhe mund të shfrytëzohet vetëm për transferimin e mjeteve nga jashtë deri në shumën e kontratës së shitjes.

2.10. Rezidentët që japin me qira pasuri të paluajtshme jashtë vendit, për shlyerjen e kërkesave në bazë të dhënies me qira të pasurisë së paluajtshme.

Fitimi i pasurisë së paluajtshme jashtë vendit vërtetohet me dëshmi të kryerjes së regjistrimit në regjistrin e investimeve në pasuri të paluajtshme në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Dhënia me qira pasurisë së paluajtshme dëshmohet me kontratën e qirasë.

Llogaria në bankën e huaj mund të çelet mbi këtë bazë vetëm në vendin ku ndodhet pasuria e paluajtshme që është lëndë e kontratës së qirasë dhe mund të shfrytëzohet vetëm për transferimin e mjeteve nga jashtë deri në shumën e qirasë të vërtetuar me kontratën e shitjes.

2.11. Rezidentët që kanë fituar pasuri të paluajtshme jashtë vendit, për të paguar shpenzimet e pasurisë së paluajtshme jashtë vendit.

Fitimi i pasurisë së paluajtshme jashtë vendit vërtetohet me dëshmi të kryerjes së regjistrimit në regjistrin e investimeve në pasuri të paluajtshme në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Shpenzimet e pasurisë së paluajtshme jashtë vendit dëshmohen me dokumentin përkatës nga i cili buron detyrimi për pagesën e tyre.

Llogaria në bankën e huaj mund të çelet mbi këtë bazë vetëm në vendin ku ndodhet pasuria e paluajtshme dhe mund të shfrytëzohet vetëm për transferimin e mjeteve nga jashtë deri në shumën e shpenzimeve.

2.12. Rezidentët që kanë detyrimin të paguajnë në bazë të blerjes së letrave me vlerë jashtë vendit dhe rezidentët që kanë letra me vlerë jashtë vendit, për qëllimet e shlyerjes së kërkesave në bazë të shitjes së letrave me vlerë jashtë vendit, dividendëve, interesave ose normave të tjera të kthimit në bazë të letrave me vlerë.

Detyrimi për të paguar gjatë blerjes së letrave me vlerë dhe shlyerjes nga shitja e letrave me vlerë jashtë vendit dëshmohet nga urdhrin për realizimin transaksionit ose raportin për realizimin e transaksionit, ose kontratë ose dokument tjetër që mund të konfirmojë transaksionin, ose dokument përkatës me të cilin mund të konfirmohet vendosja e marrëdhënies së biznesit midis rezidentit dhe pjesëmarrësit të autorizuar në bursën e huaj ose në tregun e organizuar të letrave me vlerë. Kërkesat në bazë të dividendëve, interesave ose normave të tjera të kthimit në bazë të letrave me vlerë dëshmohen me njoftim/dokument për dividendin e paguar, interesin ose normën tjetër të kthimit nga letrat me vlerë, si dhe ekstrakt nga llogaria e letrave me vlerë, e dhënë nga depozituesi i huaj përkatës.

Në urdhrin për hyrjen e ardhur, baza e transaksionit duhet të tregohet qartë (shitja e letrave me vlerë, kthimi i mjeteve të pashfrytëzuara, pagesa e dividendit, interesit ose normës tjetër të kthimit).

Llogaria në bankën e huaj ose në pjesëmarrësin e autorizuar në bursën e huaj ose në tregun e organizuar të letrave me vlerë, të kësaj nënpike, mund të shfrytëzohet vetëm për transferimin e mjeteve në dhe nga jashtë vendit, që lidhen me transaksionet me letra me vlerë jashtë vendit.

2.13. Rezidentët që kanë detyrimin për të paguar një detyrim të caktuar ndaj autoritetit kompetent/personit juridik jashtë vendit (tarifa noteriale, tarifa gjyqësore, komisione bankare ose shpenzime përmbarimi).

Detyrimi nga paragrafi 1 i kësaj nënpike dëshmohej me dorëzimin e dokumentit origjinal ose fotokopjes së vërtetuar nga organi kompetent - noteri, nga i cili do të mund të përcaktohet detyrimi i rezidentit për të kryer pagesën ndaj organit kompetent/personit juridik jashtë vendit.

Llogaria në bankën e huaj, e çelur për detyrimet nga paragrafi 1 të kësaj nënpike, mund të shfrytëzohet vetëm për transferimin e mjeteve jashtë vendit, deri në shumën e detyrimit për t'i paguar autoritetit kompetent/personit juridik.

2.14. Personat fizikë me vendbanim të përhershëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut, për dërgimin e një shume të caktuar, për të siguruar dokumentin për qëndrimin e përkohshëm jashtë vendit, për nevoja arsimore.

Detyrimi nga paragrafi 1 i kësaj nënpike dëshmohej me dokumentin e lëshuar nga institucioni arsimor kompetent i huaj, organi kompetent i huaj, përfaqësia diplomatiko-konsullore e shtetit të huaj në Republikën e Maqedonisë së Veriut, me të cilën vërtetohet se, për lëshimin e dokumentit për qëndrimin e rregulluar në atë vend për shkollim, rezidenti duhet fillimisht të çelë llogari në bankën e huaj dhe të tregojë shumën e saktë të mjeteve në llogari.

Llogaria e çelur mbi këtë bazë mund të çelet vetëm në shtetin nga i cili është lëshuar dokumenti nga institucioni kompetent arsimor i huaj, organi kompetent i huaj, përfaqësia diplomatiko-konsullore e shtetit të huaj në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe mund të shfrytëzohet për transferimin e mjeteve në dhe nga jashtë.

2.15. Personat juridikë rezidentë që kanë detyrimin për të paguar në bazë të shitjes së mallrave ose shërbimeve ndaj personit juridik nga Federata e Rusisë, për të cilin rregulloret e këtij vendi e detyrojnë rezidentin të çelë llogarinë në bankën e huaj, për pagesën e këtyre mallrave ose shërbimeve.

Detyrimi nga paragrafi 1 të kësaj nënpike vërtetohet me dorëzimin e një dokumenti origjinal ose fotokopje të vërtetuar nga organi kompetent - noteri, nga i cili do të mund të përcaktohet detyrimi i rezidentit për të kryer pagesën ndaj personit juridik në Federatën e Rusisë.

Llogaria në bankën e huaj e çelur për detyrimet e paragrafit 1 të kësaj nënpike mund të shfrytëzohet vetëm për transferimin e mjeteve jashtë vendit deri në shumën e detyrimit për t'i paguar personit juridik dhe vetëm derisa është në fuqi rregullorja e paragrafit 1 të kësaj nënpike.

3. Rezidenti mund të transferojë mjetet e llogarisë së çelur në përputhje me pikën 2, nën pikat 2.1, 2.2, 2.3, 2.4, 2.5, 2.6, 2.7, 2.8, 2.9, 2.10, 2.12 dhe 2.14 të këtij vendimi në Republikën e Maqedonisë së Veriut edhe pas skadimit të vlefshmërisë së dokumentit në bazë të të cilit është çelur llogaria.

Për qëllimet e pikës 2 të këtij vendimi, vendet që janë pjesë e Zonës së vetme të pagesave në euro (SEPA) konsiderohen si një vend i vetëm.

4. Rezidentët, personat juridikë dhe fizikë, mund të çelin lirshëm dhe të kenë llogari në institucione të pagesave ose institucione të parave elektronike jashtë vendit vetëm për qëllime komerciale, pra për blerje/shitje të mallrave dhe të shërbimeve në mënyrë elektronike. Transferet e mjeteve në llogaritë në institucionet e pagesave ose institucionet e parave elektronike jashtë vendit në bazë të blerjes së mallrave dhe të shërbimeve në mënyrë elektronike nuk duhet të kalojnë 2500 euro për person në baza mujore.

Nëse institucionet e huaja të pagesave ose institucionet e parave elektronike të paragrafit 1 të kësaj pike janë gjithashtu pjesëmarrës të autorizuar në bursën e huaj ose në tregun e organizuar të letrave me vlerë, në kuptim të nenit 14 të Ligjit të Veprimtarisë me Valuta, rezidentët, personat juridikë dhe personat fizikë mundet lirshëm të çelin dhe të kenë llogari me ta, për qëllime të blerjes/shitjes së letrave me vlerë jashtë vendit, në përputhje me përcaktimet e pikës 2.12 të këtij vendimi.

5. Rezidentët e tjerë të cilët nuk janë banka të autorizuar, mund të çelin dhe të kenë llogari në bankat e huaja, vetëm në bazë të lejes së lëshuar nga Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejshëm: Banka Popullore).

Banka Popullore i jep leje për çeljen dhe mbajtjen e llogarive në bankat e huaja rezidentit:

- që ka lidhur kontratë për kryerjen e punëve investuese jashtë vendit;
- që do të çelë përfaqësi jashtë vendit, që është pjesë përbërëse e shoqërisë tregtare;
- që kryen shërbime në transportin ndërkombëtar të mallrave dhe të udhëtarëve;
- që krye punë në fushën e veprimtarisë shkencore;
- për shlyerjen e kërkesave në bazë të vendimit gjyqësor të marrë nga një gjykatë kompetente jashtë vendit ose pajtimit jashtëgjyqësor të lidhur jashtë vendit;
- për shlyerjen e kërkesave jashtë vendit, të realizuara në bazë të kthimit të tatimit mbi vlerën e shtuar nga transaksionet tregtare;
- për shlyerjen e kërkesave jashtë vendit, të realizuara në bazë të dërgimit të mallrave ose shërbimeve të kryera sipas tenderëve ndërkombëtarë të fituar.

6. Banka Popullore jep lejen e pikës 5, paragrafi 1 të këtij vendimi në bazë të kërkesës së arsyetuar dhe dokumentacionit përkatës që rezidenti ia bashkëngjit kërkesës.

Leja e pikës 5, paragrafi 1 të këtij vendimi jepet për maksimum një vit, ndërsa në kontratat për kryerjen e punëve investuese jepet për kohëzgjatjen e kontratës.

Kërkesa e rezidentit e paragrafit 1 të kësaj pike duhet të jetë e arsyetuar dhe të përmbajë: të dhëna për kërkuesin, bazën, shumën dhe llojin e valutës, qëllimin e mjeteve, emrin e shtetit dhe të bankës së huaj ku çelet llogaria.

7. Leja e pikës 5, paragrafi 1 të këtij vendimi jepet sipas këtyre kushteve:

7.1 Për kryerjen e punëve investuese jashtë vendit, deri në 20% të vlerës së kontratës së lidhur.

Nëse ndërmjet investuesit dhe kontraktorit është rënë dakord për garanci në formën e depozitës, për kryerjen me cilësi dhe në kohë të punës së rënë dakord, leja jepet për shumën e depozitës dhe deri në skadimin e periudhës së garancisë.

Nëse gjatë kohëzgjatjes së punimeve investuese jashtë vendit, palët kontraktuese ndryshojnë afatin e kryerjes së punimeve, rezidenti është i detyruar të paraqesë në Bankën Popullore kërkesë për ndryshimin e vlefshmërisë së lejes brenda pesë ditëve të punës nga lidhja e shtojcës së kontratës.

Nëse pas përfundimit të punëve në projektin jashtë vendit, organet kompetente nuk kanë llogaritur tatimin, ndërkaq kjo përcaktohet me rregullore të shtetit, rezidenti mund të mbajë mjetet e nevojshme për të paguar tatimin në llogarinë në bankën e huaj deri në pagesën përfundimtare të tatimit.

7.2 Për pagesën e shpenzimeve të punës së zyrës përfaqësuese deri në shumën e shpenzimeve mujore të planifikuara për një periudhë njëvjeçare.

7.3 Për pagesën e shpenzimeve të përdorimit të mjeteve të transportit (shpenzime operative) për rezidentët që ofrojnë shërbime në transportin ndërkombëtar, deri në shumën e shpenzimeve mujore të planifikuara për një periudhë njëvjeçare.

7.4 Për pagesën e shpenzimeve të kryerjes së punimeve jashtë vendit në fushën e veprimtarisë shkencore, deri në shumën e shpenzimeve mujore të planifikuara për një periudhë njëvjeçare.

7.5 Për shlyerjen e kërkesave në bazë të vendimit gjyqësor të marrë nga gjykata kompetente jashtë vendit ose në bazë të pajtimit jashtëgjyqësor të lidhur jashtë vendit, deri në shumën sipas vendimit, përkatësisht pajtimit.

7.6 Për shlyerjen e kërkesave jashtë vendit të realizuara nga kthimi i tatimit mbi vlerën e shtuar, nga transaksionet tregtare, në përputhje me rregulloret tatimore të vendit në të cilin çëlet llogaria, deri në shumën e kthimit të tatimit mbi vlerën e shtuar..

7.7 Për shlyerjen e kërkesave jashtë vendit të realizuara në bazë të dërgimit të mallrave ose shërbimeve të kryera sipas tenderëve ndërkombëtarë të fituar, deri në shumën e përcaktuar në kontratën për dërgimin e mallrave ose shërbimeve të kryera, të lidhur në bazë të tenderit të fituar.

8. Bilanci në llogarinë e rezidentit në bankën e huaj nuk duhet të kalojë shumën e përcaktuar në përputhje me lejen e pikës 5, paragrafi 1 të këtij vendimi, kurse rezidenti mund të shfrytëzojë mjetet në llogarinë në bankën e huaj vetëm për qëllimin për të cilin është dhënë leja e pikës 5, paragrafi 1 të këtij vendimi.

9. Nëse rezidenti, para skadimit të afatit të përcaktuar në leje, nuk paraqet kërkesë për t'iu miratuar për të pasur një llogari në të njëjtën bankë edhe në periudhën në vazhdim, është i detyruar të mbyllë llogarinë dhe të mjetet në llogari t'i sjellë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, brenda 30 ditësh nga dita e pushimit të vlefshmërisë së lejes, përkatësisht nga dita e ndërprerjes së punës së misionit diplomatik.

Pas mbylljes së llogarisë, rezidenti i pikës 5 të këtij vendimi është i detyruar të njoftojë Bankën Popullore brenda dhjetë ditëve.

III. DOKUMENTACIONI QË DORËZOHET NË BANKËN POPULLORE PËR DHËNIEN E LEJES

10. Rezidentët që nuk janë banka të autorizuar, me kërkesën dorëzojnë këtë dokumentacion në Bankën Popullore:

10.1 Për dhënie e lejes për çeljen dhe mbajtjen e llogarisë në bankën e huaj për punë investuese:

- dëshmi që rezidenti është i regjistruar në regjistrin tregtar dhe në regjistrin e personave të tjerë juridikë për realizimin e veprimtarive që përfshijnë kryerjen e punëve

investuese jashtë vendit. Ekstrakti nga regjistri tregtar dhe regjistri i personave të tjerë juridikë duhet të jepet nga organi kompetent dhe nuk duhet të jetë më i vjetër se 3 (tre) muaj dhe

- kopje të kontratës së lidhur me ortakun e huaj, për realizimin e punëve investuese.

Nëse kërkohet zgjatja e afatit së vlefshmërisë së lejes për shkak të zgjatjes së periudhës për kryerjen e punimeve investuese, dorëzohet një kopje e shtojcës së kontratës, e cila zgjat afatin.

Nëse tatimi nuk është paguar pas përfundimit të punëve të projektit jashtë vendit, dorëzohet një kopje e rregullores përkatëse të vendit që dëshmon detyrimin për të paguar tatimin dhe dëshmia e shumës së tatimit të papaguar.

10.2 Për dhënien e lejes për çeljen dhe mbajtjen e një llogarie në bankën e huaj në bazë të pagesës së shpenzimeve të punës së përfaqësisë:

- dëshmi që rezidenti është i regjistruar në regjistrin tregtar dhe në regjistrin e personave të tjerë juridikë. Ekstrakti nga regjistri tregtar dhe regjistri i personave të tjerë juridikë duhet të jepet nga organi kompetent dhe jo më i vjetër se 3 (tre) muaj;

- një kopje të dokumentit nga autoriteti përkatës i shtetit të huaj që dëshmon se përfaqësia është e regjistruar jashtë vendit dhe

- llogaritja e shpenzimeve mujore të planifikuara për një periudhë njëvjeçare.

10.3 Për dhënien e lejes për çeljen dhe mbajtjen e llogarisë në bankën e huaj për pagesën e shpenzimeve të shfrytëzimit të mjeteve të transportit (shpenzimet operative):

- dëshmi që rezidenti është i regjistruar në regjistrin tregtar dhe në regjistrin e personave të tjerë juridikë për kryerjen e veprimtarive që përfshijnë transportin ndërkombëtar. Ekstrakti nga regjistri tregtar dhe regjistri i personave të tjerë juridikë duhet të jepet nga organi kompetent dhe nuk duhet të jetë më i vjetër se 3 (tre) muaj. Nëse për kryerjen e veprimtarisë kërkohet pëlqimi, leja ose një akt tjetër i autoritetit shtetëror, duhet të paraqitet dëshmi e pëlqimit të marrë, leja ose akti tjetër i autoritetit shtetëror, në përputhje me ligjin;

- llogaritja e shpenzimeve mujore të planifikuara për një periudhë njëvjeçare dhe
- dëshmi e zotërimit të mjeteve vetjake të transportit ose mjeteve të transportit me qira, lizing ose në shfrytëzim.

Në rastet kur rezidenti e kryen shërbimin me mjetet transportuese të marra me qira, lizing ose në shfrytëzim, bashkëngjitet kopje e kontratës së qirasë, lizingut, përkatësisht kopje e kontratës së shfrytëzimit të mjeteve transportuese.

10.4 Për dhënien e lejes për çeljen dhe mbajtjen e llogarisë në bankën e huaj për pagesën e shpenzimeve të kryerjes së punëve jashtë vendit, në fushën e veprimtarisë shkencore:

- dëshmi që rezidenti është i regjistruar në regjistrin tregtar dhe në regjistrin e personave të tjerë juridikë për kryerjen e veprimtarive që përfshijnë punë në fushën e veprimtarisë shkencore. Ekstrakti nga regjistri tregtar dhe regjistri i personave të tjerë juridikë duhet të jepet nga organi kompetent dhe nuk duhet të jetë më i vjetër se 3 (tre) muaj;

- kopje të kontratës së lidhur me një jorezident për punë jashtë vendit, në fushën e veprimtarisë shkencore dhe

- llogaritja e shpenzimeve mujore të planifikuara për një periudhë njëvjeçare.

10.5 Për dhënien e lejes për çeljen dhe mbajtjen e llogarisë në bankën e huaj për shlyerjen e kërkesave në bazë të vendimit gjyqësor të marrë nga gjykata

kompetente jashtë vendit ose në bazë të pajtimit jashtëgjyqësor të lidhur jashtë vendit:

- dëshmi që shoqëria është e regjistruar në regjistrin tregtar dhe në regjistrin e personave të tjerë juridikë. Ekstrakti nga regjistri tregtar dhe regjistri i personave të tjerë juridikë duhet të jepet nga organi kompetent dhe nuk duhet të jetë më i vjetër se 3 (tre) muaj dhe

- kopje të vendimit gjyqësor të marrë nga gjykata kompetente jashtë vendit ose kopje të pajtimit jashtëgjyqësor të lidhur jashtë vendit.

10.6 Për dhënien e lejes për çeljen dhe mbajtjen e llogarisë në bankën e huaj për pagesën e kërkesave jashtë vendit, të realizuar nga kthimi e tatimit mbi vlerën e shtuar nga transaksionet tregtare:

- dëshmi që rezidenti është i regjistruar në regjistrin tregtar dhe në regjistrin e personave të tjerë juridikë. Ekstrakti nga regjistri tregtar dhe regjistri i personave të tjerë juridikë duhet të jepet nga organi kompetent dhe nuk duhet të jetë më i vjetër se 3 (tre) muaj dhe

- dokumentacion nga një institucion kompetent jashtë vendit që do të dëshmojë se ka dalë kërkesë në bazë të kthimit të tatimit mbi vlerën e shtuar, si dhe shumën (lartësinë) e kërkesës.

10.7 Për dhënien e lejes për çeljen dhe mbajtjen e llogarisë në bankën e huaj për pagesën e kërkesave jashtë vendit, të realizuar në bazë të dërgimit të mallrave ose shërbimeve të kryera pas fitimit të tenderëve ndërkombëtarë:

- dëshmi që rezidenti është i regjistruar në regjistrin tregtar dhe në regjistrin e personave të tjerë juridikë. Ekstrakti nga regjistri tregtar dhe regjistri i personave të tjerë juridikë duhet të jepet nga organi kompetent dhe nuk duhet të jetë më i vjetër se 3 (tre) muaj dhe

- kopje të kontratës për dërgimin e mallrave ose shërbimeve të kryera, e lidhur me një jorezident, në bazë të tenderit ndërkombëtar të fituar.

11. Dokumentacioni i nevojshëm për dhënien e lejes për çeljen dhe mbajtjen e llogarisë në bankën e huaj, në përputhje me këtë vendim, duhet të dorëzohet në origjinal ose në fotokopje të vërtetuar nga personi i autorizuar (noteri), ndërkaq nëse nuk është shkruar në gjuhën maqedonase, duhet të dorëzohet dhe përkthehet nga një përkthyes i autorizuar gjyqësor.

Për të vendosur në lidhje me kërkesën për dhënien e lejes rezidentit, për çeljen dhe mbajtjen e llogarisë në bankën e huaj, Banka Popullore mund të kërkojë sqarime shtesë për dokumentacionin e dorëzuar ose dorëzimin e dokumentacionit shtesë.

Banka Popullore vendos për kërkesën për dhënien e lejes për çeljen dhe mbajtjen e llogarisë në bankën e huaj brenda 30 ditësh nga dita e dorëzimit të kërkesës së rregullt. Nëse kërkesa nuk përmban të dhënat e pikës 6, paragrafi 3 dhe/ose nuk është dorëzuar dokumentacioni i përcaktuar në pikën 10 të këtij vendimi, pra nuk janë plotësuar kushtet e pikës 7 të këtij vendimi, Banka Popullore, e refuzon me aktvendim kërkesën për dhënien e lejes për çeljen dhe mbajtjen e llogarisë në bankën e huaj

IV. KUSHTE DHE MËNYRA SIPAS TË CILAVE REZIDENTËT QË NUK JANË BANKA TË AUTORIZUARA, MUND TË ÇELIN DHE TË KENË LLOGARI NË ORGANIZATA JOBANKARE TË HUAJA

12. Personat juridikë rezidentë që nuk janë banka të autorizuar, mund të çelin dhe të kenë llogari në organizata jobankare të huaja, si llogari të evidencës për shlyerjen e kërkesave dhe detyrimeve të ndërsjella me jorezidentët, në këto raste:

- pjesëmarrësit në sistemet ndërkombëtare të kompensimit në bazë të

kontratave dhe konventave të lidhura;

- për shërbime të cilat i kryejnë në qarkullimin ndërkombëtar të mallrave dhe të udhëtarëve;

- në bazë të sigurimeve dhe

- në bazë të kontratave për bashkëpunim afatgjatë prodhues.

Bashkëpunimi afatgjatë prodhues, për qëllimet e këtij vendimi, nënkupton bashkëpunimin afatgjatë prodhues të një shoqërie tregtare vendase dhe të huaj (palë kontraktuese), në planifikimin, zhvillimin dhe prodhimin e përbashkët të produkteve në të gjitha fazat e prodhimit, si dhe të shkëmbimin e ndërsjellë dhe dërgimin e repromaterialeve, produkteve gjysmë të gatshme, pjesëve dhe produkteve të gatshme të të njëjtit lloj, për qëllimet e specializimit të prodhimit.

Para fillimit të punës përmes llogarive të evidencës, rezidentët janë të detyruar të regjistrojnë llogarinë e evidencës në Bankën Popullore.

Me kërkesën për regjistrim në evidencë, rezidenti dorëzon kontratën ose dokumentin tjetër të punës me llogari të evidencës, në origjinal ose fotokopje të vërtetuar nga personi i autorizuar (noteri).

Rezidentët kanë për detyrë të njoftojnë Bankën Popullore për ndërprerjen e punës me llogaritë e evidencës brenda 5 (pesë) ditësh pune nga dita e mbylljes së llogarisë së evidencës.

V. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

13. Lejet e dhëna nga Banka Popullore në bazë të Vendimit për mënyrën dhe kushtet sipas të cilave rezidentët që nuk janë banka të autorizuar, mund të çelin dhe të kenë llogari jashtë vendit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 165/11, 46/12, 87/12, 50/13 dhe 116/14) mbeten të vlefshme deri në afatin për të cilin janë lëshuar..

14. . Llogaritë e evidencës që janë të regjistruara në Bankës Popullore në bazë të Vendimit për mënyrën dhe kushtet sipas të cilave rezidentët që nuk janë banka të autorizuar, mund të çelin dhe të kenë llogari jashtë vendit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 165/11, 46/12, 87/12, 50/13 dhe 116/14), me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, konsiderohen se janë llogari të evidencës të regjistruara në Bankën Popullore dhe për to nuk ka nevojë të parashtrohet kërkesë përsëri.

15. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, pushon së vlefshmi Vendimi për mënyrën dhe kushtet sipas të cilave rezidentët që nuk janë banka të autorizuar, mund të çelin dhe të kenë llogari jashtë vendit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 165/11, 46/12, 87/12, 50/13 dhe 116/14).

Ky vendim hyn në fuqi tetë ditë pas botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë

O nr.02-15/II-5/2016
25 shkurt 2016
Shkup

Guvernatori
dhe kryesuesi
i Këshillit të Bankës Popullore të
Republikës së Maqedonisë
Dimitar Bogov